



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 136

Tiranë – E hënë, 18 shtator 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm, ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 132, datë 8.9.2023	Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit..... 15653
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 505, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Lituania..... 15654
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 506, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Bullgaria..... 15657
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 507, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Letonia..... 15659
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 508, datë 7.9.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 15662
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 509, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Kroacia..... 15663
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 510, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Gjermania..... 15665

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 511, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Ukraina.....	15668
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 512, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Hungaria.....	15670
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 513, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Estonia.....	15673
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 514, datë 7.9.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë.....	15675
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 515, datë 7.9.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë..	15676
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 516, datë 7.9.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Holandës...	15677
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 517, datë 7.9.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	15678
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 518, datë 7.9.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Francës.....	15679
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 519, datë 7.9.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në republikën e Çekisë.	15680
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 520, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Italia.....	15681
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 521, datë 7.9.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Bosnjë-Hercegovina.....	15683
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 253, datë 23.8.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw (AC).....	15685
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 254, datë 23.8.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw.....	15687

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 255, datë 23.8.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.....	15688
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 256, datë 23.8.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Gealb Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i bardhë 1” me fuqi të instaluar 5360 kw dhe “Guri i bardhë 2”, me fuqi të instaluar 3940 kw, me fuqi totale të instaluar 9300 kw.....	15689
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 257, datë 23.8.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 195, datë 30.8.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Derbi-E’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Antena’, me kapacitet të instaluar 1105”.....	15691
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 258, datë 23.8.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.1.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Diezela’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Ljusa’, me kapacitet të instaluar 1980 kw”, i ndryshuar.....	15692
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 392/16, datë 14.9.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 662, datë 13.10.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimin të Unazës së Madhe, Tiranë, nga Sheshi Shqiponja–Bulevardi i Ri’ dhe rikualifikimi i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6”, i ndryshuar.....	15693



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 132, datë 8.9.2023

PËR NGRITJEN E AUTORITETIT
PËRGJEGJËS PËR IDENTIFIKIMIN,
REFERIMIN, MBROJTJEN DHE
RIINTEGRIMIN E VIKTIMAVE DHE
VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË
TRAFIKIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 10.11.2021, “Për një shtesë në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe planin e veprimit 2021–2022’, të ndryshuar”,

UDHËZOJMË:

1. Ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, në vijim referuar si “Autoriteti Përgjegjës”.

2. Autoriteti përgjegjës të ketë këtë përbërje:

a) Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Antitrafikut dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme – kryetar;

b) 1 (një) përfaqësues nga Sektori kundër Trafikeve të Paligjshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar;

c) 1 (një) përfaqësues nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar;

d) 1 (një) përfaqësues nga Sektori i Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së të Miturve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar;

e) 1 (një) përfaqësues nga Sektori kundër Krimit Kibernetik, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar;

f) 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria Konsullore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme – anëtar;

g) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – anëtar;

h) 1 (një) përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës – anëtar;

i) 1 (një) përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror – anëtar;

j) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit – anëtar;

k) 1 (një) përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive – anëtar;

l) 1 (një) përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore – anëtar;

m) Kryetari i Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik (KKSAT) – anëtar.

3. Në mbledhjet e Autoritetit Përgjegjës ftohen të jenë të pranishëm përfaqësues nga Prokuroria kompetente dhe përfaqësues nga anëtarë të tjerë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, në varësi të nevojave për mbështetje dhe ekspertizë, sipas rasteve që do të trajtohen.

4. Autoriteti Përgjegjës është struktura mbështetëse e Mekanizmit Kombëtar të Referimit në procesin e identifikimit, referimit për ndihmë, mbrojtje, riintegrim të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, në përputhje me procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

5. Autoriteti Përgjegjës ndjek regjistrimin dhe raportimin periodik të të dhënave për rastet e trafikimit të identifikuar dhe të referuara nga institucione shtetërore dhe organizatat në përputhje me procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

6. Autoriteti Përgjegjës hedh dhe administron informacionet në Bazën Kombëtare të të Dhënave për Viktimat e Trafikimit, sipas rubrikave përkatëse, mbi çdo rast të identifikuar dhe të referuar.

7. Autoriteti Përgjegjës mbledhet në mënyrë periodike të paktën një herë në muaj, në varësi të rasteve të referuara.

8. Koordinimi i veprimtarisë administrative të Autoritetit Përgjegjës ndiqet nga sekretariati, i cili përbëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe specialisti i Sektorit të Antitrafikut në Drejtorinë e Politikave të Antitrafikut dhe Migracionit, në Ministrinë e Brendshme.

9. Sekretariati është përgjegjës për njoftimin e anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës, organizimin e takimeve periodike dhe të takimeve jashtë radhe,



sipas nevojave, mbajtjen e korrespondencës me anëtarët, dokumentimin e takimeve dhe të veprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Përgjegjës.

10. Sekretariati është përgjegjës për mbledhjen, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave që raportohen nga anëtarët e Autoritetit Përgjegjës dhe hartimin e raporteve sipas kërkesave. Raportet e hartuara nga Sekretariati janë objekt vlerësimi dhe miratimi i të gjithë anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës.

11. Autoriteti Përgjegjës i raporton, në mënyrë periodike një herë në muaj, për gjithë veprimtarinë e tij, drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendësministrit në Ministrinë e Brendshme, të cilët mbulojnë fushën e përgjegjësisë së antitrafikut.

12. Të merren të gjitha masat për krijimin, plotësimin e infrastrukturës, logjistikës dhe financimit të nevojshëm, në drejtoritë përkatëse të këtyre institucioneve, për të trajtuar referimet e të gjitha viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe për të kryer të gjitha funksionet e tjera të bashkërendimit dhe raportimit, të cilat iu kërkojnë sipas këtij udhëzimi.

13. Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, si dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik, përveç sa parashikohet në këtë udhëzim, mund të trajtojnë në mënyrë më të detajuar çështje të interesit të përbashkët, nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta, që mund të lidhin për këtë qëllim.

14. Ngarkohet Autoriteti Përgjegjës të hartojë rregulloren e veprimit dhe të funksionimit të tij, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

15. Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Punëve të Jashtme, ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nr. 3799 prot., datë 8.7.2014, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”, shfuqizohet.

16. Ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Autoriteti Përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I FINANCËVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

URDHËR
Nr. 505, datë 7.9.2023

**PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË
LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE,
NËNPRODUKTEVE TË TYRE,
MATERIALIT BIOLOGJIK,
EMBRIONEVE, MISHIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE
NGA LITUANIA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të neneve 42 dhe 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Lituanisë:



Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Alytaus	Alytaus	
Alytaus	Varėnos	
Kauno	Kėdainių	
Kauno	Kauno	
Kauno	Kaišiadorių	
Kauno	Prienų	
Kauno	Jonavos	
Klaipėdos		
Marijampolės		
Šiauliai	Akmenės	
Šiauliai	Šiaulių	
Tauragės	Tauragės	
Tauragės	Jurbarko	
Tauragės	Šilalės	
Telšiai	Telšių	
Telšiai	Plungės	
Utenos	Anykščių	
Utenos	Molėtų	
Utenos	Zarasų	
Utenos	Utenos	
Utenos	Ignalinos	
Utenos	Zarasų	
Vilniaus		
Panevezio	Rokiškio	
Panevezio	Biržų	

1.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca

demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit.

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;



b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

c) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

1.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenin 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në

një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar, për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 460, datë 25.7.2023, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga, Lituania”, shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së



Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 506, datë 7.9.2023

**PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË
LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE,
NËNPRODUKTEVE TË TYRE,
MATERIALIT BIOLOGJIK,
EMBRIONEVE, MISHIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA
BULLGARIA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Bullgarisë:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Blagoevgrad		
Burgas		
Dobrich		
Gabrovo		
Haskovo		
Kardzhali		
Kyustendil		
Pazardzhik		
Pernik		
Plovdiv		

Montana	Valchedram	
Razgrad		
Ruse		
Shumen		
Sliven		
Smolyan		
Sofia		
Stara Zagora		
Tragovishte		
Varna		
Veliko Tarnovo		
Yambol		
Lovech		

1.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtagës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtagës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtagës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtagës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.



1.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

1.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar, për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të nenëve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**



a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 464, datë 25.7.2023, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Bullgaria”, shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR

Nr. 507, datë 7.9.2023

PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA LETONIA

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Letonisë:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Kurzemes	Dienvidkurzemes	Sakas
Kurzemes	Dienvidkurzemes	Kalētu
Kurzemes	Kuldīgas	Ēdoles
Kurzemes	Kuldīgas	Skrundas
Kurzemes	Kuldīgas	Padures
Kurzemes	Kuldīgas	Raņķu
Kurzemes	Kuldīgas	Alsungas
Kurzemes	Saldus	Pampālu
Kurzemes	Talsu	Libagu
Kurzemes	Talsu	Dundagas
Kurzemes	Tukuma	Slampes
Kurzemes	Tukuma	Degoles
Kurzemes	Tukuma	Vārkavas
Kurzemes	Tukuma	Smārdes
Kurzemes	Tukuma	Jaunpils
Kurzemes	Tukuma	Irlavas
Kurzemes	Ventspils	Vārves
Kurzemes	Ventspils	Zlēku
Kurzemes	Ventspils	Ugāles
Kurzemes	Ventspils	Piltēnes
Kurzemes	Ventspils	Užavas
Latgales	Augšdaugavas	Vecsalienas



Latgales	Augšdaugavas	Demenes
Latgales	Augšdaugavas	Maļinovas
Latgales	Augšdaugavas	Salienas
Latgales	Balvu	Lazdulejas
Latgales	Balvu	Kubulu
Latgales	Balvu	Lazdukalna
Latgales	Balvu	Šķilbēnu
Latgales	Balvu	Balvu
Latgales	Balvu	Tilžas
Latgales	Balvu	Rugāju
Latgales	Balvu	Briežuciema
Latgales	Briežuciema	Kantinieku
Latgales	Krāslavas	
Latgales	Līvānu	Rožupes
Latgales	Līvānu	Turku
Latgales	Ludzas	Nukšu
Latgales	Preiļi	Rušonas
Latgales	Preiļi	Riebiņu
Latgales	Preiļi	Silajānu
Latgales	Preiļi	Aizkalnes
Latgales	Preiļi	Saunas
Latgales	Rēzeknes	Gaigalavas
Latgales	Rēzeknes	Silmalas
Latgales	Rēzeknes	Ilzeskalna
Latgales	Rēzeknes	Gaigalavas
Latgales	Rēzeknes	Vērēmu
Latgales	Rēzeknes	Audriņu
Latgales	Rēzeknes	Bērzgales
Latgales	Rēzeknes	Dekšāres
Latgales	Rēzeknes	Nagļu
Montana	Valchedram	
Rīgas	Siguldas	Krimuldas
Rīgas	Siguldas	
Vārmes	Kuldīgas	Vārmes
Vidzemes	Alūksnes	
Vidzemes	Cēsu	Raiskuma
Vidzemes	Cēsu	Stalbes
Vidzemes	Cēsu	Straupes
Vidzemes	Gulbenes	
Vidzemes	Limbažu	
Vidzemes	Madonas	
Vidzemes	Smiltenes	
Vidzemes	Valmieras	
Vidzemes	Ventspils	
Vidzemes	Varakļānu	
Zemgales	Dobeles	Annenieku
Zemgales	Jelgavas	Valgundes
Zemgales	Aizkraukles	
Zemgales	Jēkabpils	

1.1 Pār kafshēt e gajalla tē llojīt derra tē butē dhe tē egēr, **certifikata shēndetēsore veterinarē duhet tē vērtetojē qē kafshēt:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike tē murtajēs afrikane tē derrave ditēn e dērgesēs;

b) janë mbajtur qē nga lindja ose pēr tre muajt e fundit nē një kompartament (zonē) pa prezencē tē murtajēs afrikane tē derrave; ose

c) janë mbajtur nē një stacion karantine, tē izoluar pēr 30 ditē pērpara dērgesēs dhe i janë nēnshtuar një testi virologjik dhe një testi serologjik tē kryer tē paktēn 21 ditē pas hyrjes nē stacionin e karantinēs, me rezultate negative.

1.2 Pēr materialin biologjik tē kafshëve tē llojīt derra tē butē ose tē egēr, **certifikata shēndetēsore veterinarē duhet tē vērtetojē qē kafshēt donatore tē materialit biologjik:**

a) janë mbajtur qē nga lindja ose pēr tē paktēn tre muaj para grumbullimit nē një stacion, nē tē cilin janë mbikēqyrur, nē pērputhje me nenet 15.1.28 deri nē 15.1.30 tē Kodit Terrestrial tē OIE-sē dhe vērteton se asnjē rast i murtajēs afrikane tē derrave, nuk ka ndodhur nē tri vitet e fundit. Kjo periudhē reduktohet nē 12 muaj, vetēm nēse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dēshmi tē pērfshtirjes sē rriqnave nē epidemiologjinē e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike tē murtajēs afrikane tē derrave nē ditēn e mbledhjes sē materialit biologjik;

c) sperma ēstē mbledhur, pērpunuar dhe ruajtur nē pērputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 tē Kodit Terrestrial tē OIE-sē;

ç) sperma e pērdorur pēr fekondimin e ovociteve ēstē nē pērputhje me kushtet e pērcaktuara nē nenin 15.1.10 ose nē nenin 15.1.11 tē Kodit Terrestrial tē OIE-sē, sipas rastit.

1.3 Pēr embrionet e derivuara *in vivo* tē derrave tē butē, **certifikata shēndetēsore veterinarē duhet tē vērtetojē qē kafshēt donatore tē embrioneve:**

a) janë mbajtur qē nga lindja ose pēr tē paktēn tre muaj para grumbullimit tē embrioneve nē një stacion, nē tē cilēn janë mbikēqyrur nē pērputhje me nenet 15.1.28 deri nē 15.1.30 tē Kodit Terrestrial tē OIE-sē dhe vērteton se asnjē rast i murtajēs afrikane tē derrave, nuk ka ndodhur nē tri vitet e fundit. Kjo periudhē reduktohet nē 12 muaj, vetēm nēse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dēshmi tē pērfshtirjes sē rriqnave nē epidemiologjinē e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjē klinike tē murtajēs afrikane tē derrave nē ditēn e mbledhjes sē embrioneve;



c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

1.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur



kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 466, datë 25.7.2023, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Letonia”, shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4 Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 508, datë 7.9.2023

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
- b) zogjve 24-orësh;

- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve;
- e) nënprodukteve të shpendëve.

Nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3	*Bashkia/fshat/provincë
1.	Kujawsko-Pomorskie	Sępólno	Kamień Krajeński	Duża Cerkwica
2.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Inowrocław (rural)	Marcinkowo
3.	Kujawsko-Pomorskie	Tuchola	Kęsowo	Pamiętowo
4.	Kujawsko-Pomorskie	Świecie	Świecie	Chrystkowo
5.	Łódzkie	Łęczyca	Grabów	Stary Besk
6.	Małopolskie	Gorlice	Gorlice (rural)	Bielanka
7.	Małopolskie	Gorlice	Bobowa	Bobowa
8.	Małopolskie	Nowy Sącz	Kamionka Wielka	Myszków
9.	Małopolskie	Nowy Sącz	Chelmic	Biezyce Góme
10.	Małopolskie	Gorlice	Sękowa	Owczary
11.	Małopolskie	Gorlice	Biecz	Strzeszyn
12.	Małopolskie	Gorlice	Bobowa	Wilczyńska
13.	Małopolskie	Gorlice	Gorlice (rural)	Bielanka
14.	Małopolskie	Kraków	Kocmyrzów-Luborzyca	
15.	Mazowieckie	Piaseczno	Prąmów	Wola Prąmowska
16.	Mazowieckie	Wołomin	Wołomin	Mazowieckie Voivodeship
17.	Mazowieckie	Mińsk	Halinów	Mazowieckie Voivodeship
18.	Mazowieckie	Wołomin	Radzymin	Mazowieckie Voivodeship
19.	Mazowieckie	Zuromin	Lutocin	Swojcin
20.	Opolskie	Głubczyce	Głubczyce	Równa
21.	Podkarpackie	Przeworsk	Przeworsk	Przeworsk
22.	Pomorskie	Człuchów	Debrzno	Buchowo
23.	Śląskie	Bielsko	Bestwina	Bestwinka
24.	Śląskie	Zawiercie	Szczekociny	Szczekociny
25.	Śląskie	Tamowskie Góry	Tworóg	Brynek
26.	Śląskie	Tamowskie Góry	Zbrosławice	Kopienica
27.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)	Windyki
28.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)	Rudzienice
29.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)	Łosy
30.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)	Gromoty
31.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)	Nowa Wieś
32.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Zalewo	
33.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Biskupiec	Warmińsko-Mazurskie Voivodeship
34.	Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Kętrzyn (rural)	
35.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Nowe Miasto Lubawskie (rural)	
36.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik	
37.	Dolnośląskie	Wrocław	*Wrocław	
38.	Kujawsko-Pomorskie	Grudziądz	*Świecie Nad Osa	



39.	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	*Kikół	
40.	Łódzkie	Zduńska Wola	*Szadek	
41.	Łódzkie	Poddębice	*Uniejów	
42.	Łódzkie	Tomaszów Mazowiecki	*Rokiciny	
43.	Łódzkie	Skierzwice	Maków	
44.	Lubuskie	Krosno Odrzańskie	Krosno Odrzańskie	
45.	Lubuskie	Zielona Góra (City)	*Zielona Góra	
46.	Opolskie	Namysłów	*Pokój	
47.	Śląskie	Zawiercie	*Łazy	
48.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	*Zalewo	
49.	Warmińsko-Mazurskie	Pisz	*Pisz	
50.	Wielkopolskie	Szamotuły	*Duszniki	
51.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	*Grabów Nad Prosną	
52.	Wielkopolskie	Turek	*Przykona	
53.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	*Mikstat	
54.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	*Sieroszewice	
55.	Wielkopolskie	Kalisz	*Opatówek	
56.	Wielkopolskie	Kalisz	*Żelazków	
57.	Wielkopolskie	Pleszew	*Pleszew	
58.	Wielkopolskie	Kalisz	*Ceków-Kolonia	
59.	Wielkopolskie	Pleszew	*Goluchów	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 230, datë 19.7.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 20 mw (AC).

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.7.2023 dhe 21.7.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 18.8.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1888/3 prot., datë 21.7.2023, ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 230/2023 dhe evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet. ERE, me shkresën nr. 1893/5 prot., datë 28.7.2023 ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k.

- Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1888/4 prot., datë 1.8.2023 dhe nr. 1888/6 prot., datë 10.8.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e licencës sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht

dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastin konkret shoqëria ka plotësuar në formatin përkatës afatin e pritshmërisë së jetëgjatësisë së centralit 35 vjet, ndërkohë që rezultoi se ka dokumentuar që garancia e tij është 30 vjet, ndaj në këto rrethana ERE kushtëzohet nga parashikimet ligjore dhe garancia për jetëgjatësinë e centralit në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, pra për 30 vjet.

- Për sa parashikohet në VNM-në paraprake, në lidhje me zbatimin në terren të projektit, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaiik, deri më datë 21.2.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e kësaj VNM-je).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 20 mw (AC), për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaiik, deri më datë 21.2.2024.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të informacionit sipas përcaktimeve të pikës 2, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data



e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 254, datë 23.8.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“G.S.K.” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1931/7 prot., datë 17.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë ‘G.S.K.’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw”, konstatoi se:

- Shoqëria “G.S.K.” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1931 prot., datë 17.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038,

fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 237, datë 27.7.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.7.2023 dhe 29.7.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 6.8.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1931/3 prot., datë 31.7.2023, depozitoi dokumentacion plotësues të këtij aplikimi. ERE, me shkresën nr. 1931/4 prot., datë 8.8.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 237/2023, dhe evidentoi dokumentacionin që mbetej ende pa plotësuar. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1931/5 prot., datë 14.8.2023, depozitoi dokumentacion plotësues të këtij aplikimi. ERE me shkresën nr. 1931/6 prot., datë 16.8.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e licencimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “G.S.K.” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se, nga sa deklaruar nga shoqëria, rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga



kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë, deri në 25 vjet.

- Për sa parashikuar në VNM-në paraprake, në lidhje me zbatimin në terren të projektit, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaiik, deri më datë 23.6.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e kësaj VNM-je).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaiik, deri më datë 23.6.2024.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të informacionit, sipas përcaktimeve të pikës 2, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “G.S.K.” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 255, datë 23.8.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “TEKSOEN 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/1 prot., datë 18.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik ‘Teksoen 1’, me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2033 prot., datë 16.8.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s një pagesë më të vogël se ajo e parashikuar në aneksin A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në vijim do të njoftohet subjekti që të kryejë pjesën e mbetur të pagesës për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.



- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; dhe pikën 2.1, germat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 2.1

- Germa “a”: Aplikuesi duhet të plotësojë shtojcën 2 me informacion mbi llojin e paneleve, nëse janë *on shore* apo *off shore*.

- Aplikuesi duhet të bëjë saktësimet përkatëse për jetëgjatësinë e pritshme të centralit, nga do të varet dhe afati i vlefshmërisë së licencës.

- Duke qenë se shoqëria ka parashikuar të fillojë punimet në vitin 2023, por në kuadër të vlefshmërisë dhe VNM-së paraprake të depozituar në ERE, vlerësohet t’i kërkohej informacion nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaiik.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 256, datë 23.8.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEALB ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET “GURI I BARDHË 1” ME FUQI TË INSTALUAR 5360 kw DHE “GURI I BARDHË 2” ME FUQI TË INSTALUAR 3940 kw, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 9300 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2042/1 prot., datë 21.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Gealb Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet ‘Guri i Bardhë 1’ me fuqi të instaluar 5360 kw dhe ‘Guri i Bardhë 2’ me fuqi të instaluar 3940 kw, me fuqi totale të instaluar 9300 kw, në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GEALB ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2042 prot., datë 17.8.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), fshati Guri i Bardhë, Njësia



Administrative Xibër, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kw.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e licencimit, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “GEALB ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar, në zbatim të përcaktimeve të rregullores, dokumentacionin për nenin 9, pikën 1.1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat: “a”, “c” dhe “d”, si dhe për pikën 2, gerrat: “a”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9, Format i dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore nga Drejtoria e Burgjeve për administratorin dhe shoqërinë “Glealb Energy” sh.p.k.

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “a”: të vërtetojë që nuk ka detyrime në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore;

- germa “b”: të sjellë letër interesi të rinovuar në afate, që reflekton interesin e bankës për financimin e këtij investimi, duke saktësuar normën e financimit, ose të dokumentojë/informojë në ERE nëse shoqëria ka nënshkruar ndonjë marrëveshje me bankën apo kontratë financiare, origjinale/të njësuar me origjinalin;

- germa “c”: të depozitojë planin e biznesit në format origjinal/ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE shtojcën 2 të plotësuar:

- germa “b”: të depozitojë në ERE, kontratën e koncensionit, amendimin e kontratës dhe kontratën shtesë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

- germa “c”: të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GEALB ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1”, “Guri i Bardhë 2”, në rrjedhën e përrrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapacitet të instaluar 9300 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 257, datë 23.8.2023

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 195, DATË
30.8.2018, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘DERBI-E’ SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
‘ANTENA’, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1105”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1711/2 prot., datë 18.8.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 195, datë 30.8.2018, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Derbi-E’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Antena’ me kapacitet të instaluar 1105kw”,”

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 195, datë 30.8.2018, ka vendosur:

“1. Të licencojë shoqërinë “Derbi-E” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Antena” me fuqi 1105 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Derbi-E” sh.p.k., në përfundim të afati 5-vjeçar të kontratës së qirasë me Bashkinë Mat, të depozitojë në ERE kontratën e rifreskuar.”

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 195/2018, shoqëria ka depozituar kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Mat për HEC “Antena”, me afat vlefshmërie 10 (dhjetë) vjet, deri më datë 7.4.2033, me të drejtë rinovimi.

- Ky afat nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë, ndaj vlerësohet që pika 2, e vendimit të Bordit nr. 195/2018, të ndryshohet duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitojë në ERE kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Mat, jo më vonë se data 7.4.2033, ose

çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.

- Me shkresën e depozituar në ERE me nr. 1116/4 prot., datë 11.4.2023, shoqëria ka depozituar lejen e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor me nr. serie 000082, nr. 3 prot., datë 24.2.2023, të miratuar me vendimin nr. 1, datë 8.2.2023, të Këshillit të Basenit Ujqor Mat për përdorim të burimit ujqor për HEC “Antena”, me një afat 5-vjeçar, deri më 8.2.2028.

- Shoqëria ka qenë e pajisur me leje për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor të vlefshme në momentin e aplikimit, për këtë arsye nuk i është lënë kusht në vendimin e Bordit nr. 195/2018.

- Me depozitimin e lejes për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor, lind nevoja të shtohet një pikë në vendimin e licencimit, meqenëse kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar, për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie, nga HEC “Antena”, brenda datës 8.2.2028.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të ndryshimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 195, datë 30.8.2018, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Derbi-E” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Mat, jo më vonë se data 7.4.2033, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti, si dhe lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Antena”, brenda datës 8.2.2028.”

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Derbi-E” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të



Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 258, datë 23.8.2023

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 16, DATË
23.1.2020, ‘MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘DIEZELA’ SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
‘LJUSA’, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1980 kw’, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1851/3 prot., datë 17.8.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.1.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Diezela’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Ljusa’, me kapacitet të instaluar 1980 kw, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 16, datë 23.1.2020, të ndryshuar me vendimin nr. 218, datë 4.7.2023, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Diezela” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar (duke filluar nga data 23.1.2020), me kusht që, përpara fillimit të operimit të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin

e burimit uJOR për prodhim hidroenergjie nga HEC “Ljusa”.

2. Shoqëria “Diezela” sh.p.k. të informojë ERE-n, çdo tre muaj, në lidhje me: i. pajisjen me lejen e rinovuar për përdorimin e burimit uJOR; ii. fillimin e punimeve të ndërtimit të veprës, por jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së VNM-së paraprake, deri më 9.3.2024.

3. Shoqëria “Diezela” sh.p.k. të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar të qirasë të lidhur me Bashkinë Burrel brenda datës 24.1.2023, ose regjistrimin në ASHK-në përkatëse të kontratës të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1851/1 prot., datë 3.8.2023, duke i njoftuar ndryshimin e vendimit nr. 16/2020, me vendimin nr. 218/2023, duke i evidentuar kushtet e lëna në këtë vendim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1851/2 prot., datë 9.8.2023, shoqëria ka depozituar lejen e përdorimit të burimit uJOR sipërfaqësor me nr. serie 000096, nr. 24 prot., datë 16.6.2023, të miratuar me vendimin nr. 16, datë 29.5.2023, të Këshillit të Basenit UJOR Mat për përdorim të burimit uJOR për HEC “Ljusa”, me një afat 5-vjeçar, deri më 29.5.2028.

- Me depozitimin e lejes për përdorimin e burimit uJOR sipërfaqësor, rezultoi se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, të vendimit të Bordit nr. 16/2020, të ndryshuar, ndaj si e tillë vlerësohet të hiqet kushti i mos fillimit të operimit, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet të shtohet një pikë në vendim, duke i lënë kusht shoqërisë që të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit uJOR sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Ljusa” brenda datës 29.5.2028.

- Gjithashtu me depozitimin e lejes së përdorimit të burimit uJOR sipërfaqësor shoqëria ka plotësuar dhe kushtin e lënë në pikën 2, germa “i”, për raportim çdo 3 muaj, në lidhje me pajisjen me leje të rinovuar të burimit uJOR sipërfaqësor, por germa “ii” e kësaj pike ngelet e pandryshuar duke qenë se shoqëria e ka të vlefshme VNM-në deri në datën 9.3.2024.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e



ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.1.2020, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “Diezela” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar (duke filluar nga data 23.1.2020).”.

2. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.1.2020, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Diezela” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Ljusa” brenda datës 29.5.2028, si dhe të informojë ERE-n, çdo tre muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të veprës, por jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së VNM-së paraprake, deri më 9.3.2024.”.

3. Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.1.2020, ndryshon dhe bëhet:

“ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve, sipas përcaktimeve dhe afateve si më sipër.”.

4. Drejtorja e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Diezela” sh.p.k., Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. dhe “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 392/16, datë 14.9.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 662, datë 13.10.2022, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimin të Unazës së Madhe, Tiranë, nga Sheshi Shqiponja–Bulevardi i Ri’ dhe rikualifikimi i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6”, i ndryshuar.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa vlerësimi i ndërtesës është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jobanimi”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 319,172,695 (treqind e nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

DREJTOR I PËGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim



RISHIKIMI I PROJEKTIT PËR SEGMENTIN RRUGOR TË VAZHDIMIT TË UNAZËS SË MADHE TË TIRANËS
NGA SHESHI SHQIPONJA–BULEVARDI I RI
RIKUALIFIKIMI I UNAZËS LINDORE PËR LOTET 4, 5, 6
(SHTESA)

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	TË DHËNAT E PASURISË			TOKË "TRUALL"				Sip. totale m ²	TOKË "ARË"			NDËRTESË SOC. EK			OBJEKT BANIMI				Vlera totale (LEKË)	SHËNIME			
				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m ²	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera lekë		Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera lekë	Sip. totale m ²	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Vlera sipas preventivit lekë	Sip. totale m ²	Sipërfaqja e shpronësuar (m ²)	Çmimi m ²	Vlera lekë					
1	Ismet	Izet	Grua	3976	136/545-ND	Ndërtesë								-				93.00	93.00	61,167.00	5,688,531.00	5,688,531.00	Kjo ndërtesë pozicionohet mbi pasurinë 136/545 vol. 29, f. 94, l. leg.			
2	Dhurim	Rasim	Murati	3976	68/27	Arë					550.00	550	448	246,400.00								246,400.00	ITTR do të sillet gjatë publikimit të kërkesës për shpronësim			
3	Xhevdet	Osman	Ruçi	3976	136/412	Truall	335.00	22.6	479.00	10,825.40				-								10,825.40	Kontrate për vendosje e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, sipas vlerave të kredisë			
4	Latif Anife	Agush Mehmet	Saraci Saraci	3976	136/392-nd	Ndërtesë								-				246.10	246.10	61,167.00	15,053,198.70	15,053,198.70	Kjo ndërtesë ndodhet mbi pasurinë nr. 136/392, vol. 21, f. 152.			
5	Hasan	Sali	Kuri	3976	68/13	Arë					307.00	307	448	137,536.00								0.00	137,536.00	Kontrate për vendosje e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, sipas vlerave të kredisë		
6	Bokumje Drita Mira Lumturije Edmond		Spaja Spaja Spaja Spaja	3976	68/15	Arë					1,380.00	324	448	145,152.00								0.00	145,152.00			
7	Eqerem	Latif	Hasa	3976	35/6	Arë					410.00	410	448	183,680.00								183,680.00				
8	Alin	Musa	Jahollari	3976	136/185	Truall + ndërtesë												148.00	148.00	61,167.00	9,052,716.00	9,052,716.00	Me kusht që gjatë publikimit të kërkesës do të sillet aktet ekspertizë mbi qëndrueshmërinë e objektit.			
9	Kastriot	Musa	Jahollari	3976	136/284	Truall + ndërtesë												164.00	164.00	61,167.00	10,031,388.00	10,031,388.00	Me kusht që gjatë publikimit të kërkesës do të sillet aktet ekspertizë mbi qëndrueshmërinë e objektit.			
10	Jomus	Musa	Jahollari	3976	136/283	Truall + ndërtesë	159.00	4.4	479.00	2,107.60								163.60	163.60	61,167.00	10,006,921.20	10,009,028.80				
11	Yllion	Mete	Morati	2460	606/0ND10	Ndërtesë								-				118.40	118.40	66,505.00	7,874,192.00	7,874,192.00	Kjo ndërtesë pozicionohet mbi pasurinë nr. 606, vol. 5, f. 242 l. leg.			
12	Avdi	Hysen	Avdi	3976	18/ND1	Ndërtesë								-				143.80	143.80	61,167.00	8,795,814.60	8,795,814.60				
13	Tefta Mardin Armando	Hysen Aleksander Aleksander	Demko Demko Demko	3976	18/3-ND	Ndërtesë												187.10	187.10	61,167.00	11,444,345.70	11,444,345.70	Me kusht që gjatë publikimit të kërkesës për shpronësim, sipërfaqja e verandës të vlerësohet me situacion punimesh.			
14	Illa	Shine	Zhebi	3976	35/52/ND	Ndërtesë								-				108.60	108.60	61,167.00	6,642,736.20	6,642,736.20	Kjo ndërtesë pozicionohet mbi pasurinë nr. 35/52, vol. 8, f. 112.			
15	Artur	Xhevaie	Salla	1066	221/10	Ndërtesë								-				90.00	90.00	52,000.00	4,680,000.00	4,680,000.00	Kartela e pasurisë do të sillet gjatë publikimit të kërkesës për shpronësim.			
16	Manjola	Nesim	Haxhillari	1066	221/11	Ndërtesë								-				90.00	90.00	52,000.00	4,680,000.00	4,680,000.00				
17	Yll Edisllata	Arif Admir	Prozlioni Prozlioni	1066	985/22	Truall + ndërtesë	168.6	97.8	3,560.00	348,168.00								56.20	56.20	52,000.00	2,922,400.00	3,270,568.00				
18	Durim Maran	Hekuran Durim	Pere Pere	8170	5/659	Truall	366.1	120	32,878.00	3,945,360.00				-								3,945,360.00				
19	Sirja Mehmet Nesi Jetnor	Ramadan Ramadan Ramadan	Peleshka Peleshka Peleshka	8170	5/485	Truall	434	35.9	32,878.00	1,180,320.20				-								1,180,320.20				
20	Hysni	Refik	Sina	8170	5/215	Truall	174.9	49.7	32,878.00	1,634,036.60				-								1,634,036.60				
21	Artan	Rahim	Kulloli	8170	3/1091	Truall	300	300	32,878.00	9,863,400.00												9,863,400.00				
22	Venetik	Servet	Sorra	8170	5/656	Truall	322	45.6	32,878.00	1,499,236.80				-								1,499,236.80				
23	Idriz	Ramadan	Krasniqi	8120	3/15/ND	Ndërtesë								-				82.2	82.2	81,666.61	6,712,995.34	6,712,995.34	Kjo ndërtesë ngrihet mbi pasurinë me nr. 3/15.			
24	Xhelal	Ymer	Hida	8120	3/18/ND	Ndërtesë												30	30	81,666.61	2,449,998.30	2,449,998.30	Kjo ndërtesë ngrihet mbi pasurinë me nr. 3/18.			
25	Pashke Landra Sekel Klodian	Prend Pashk Pashk Pashk	Luli Gjinaj Luli Luli	8310	11/204-ND	Ndërtesë												155.8	155.8	96,753.41	15,074,181.28	15,074,181.28	Kjo ndërtesë pozicionohet mbi pasurinë nr. 11/204, vol. 32, f. 247, shk. 8310, titulli i pronësisë vendimi nr. 2738, datë 18.2.2022, për leg. e ndërtimit pa leje ASHK-së DVT Ven i vlefshëm vetëm për ndërtesën			
26	Prena	Lulash	Leraj	8310	10/272	truall	183	183	31,219.00	5,713,077.00				-								0.00	5,713,077.00	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm		



27	Bibil Llan	Llan	Lasku Lasku	8110	7/325	Truall + ndërtesë	414.1	223.8	23,703.00	5,304,731.40							359.9	359.9	60,959.00	21,939,144.10	27,243,875.50	
28	Fatmir Lulezim Lamane	Skender Skender Llap	Kamberaj Kamberaj Kamberaj	8110	5/589	Truall + ndërtesë	300	270.6	23,703.00	6,414,031.80							332.6	332.6	60,959.00	20,274,963.40	26,688,995.20	
29	Lek	Gjergj	Fufi	8110	5/41-nd	Apartament								-			38	38	60,959.00	2,316,442.00	2,316,442.00	Shteti është pronarë i truallit 5/41 mbi të cilin është ndërtesa 5/41-nd ndalohen veprimet mbi këtë pasuri deri në rregullimin e marrëdhënieve ligjore me truallin dhe regjistrimin i parrëgjall në sistemin hipotekor.
30	Tomor	Alush	Gjyla	2884	308/2	Truall + ndërtesë	500.00	457.7	3,560.00	1,629,412.00			-				196.5	196.50	52,000.00	10,218,000.00	11,847,412.00	
31	Majlën	Muhareem	Noka	2884	305/3	Truall + ndërtesë	162	90.1	3,560.00	320,756.00			-				190.1	190.1	52,000.00	9,885,200.00	10,205,956.00	
32	Fatos	Muhareem	Noka	2884	305/18+1-1	Apartament							-				83.9	83.9	52,000.00	4,362,800.00	4,362,800.00	
33	Muhareem	Rahim	Noka	2884	305/18+1-2	Apartament							-				83.9	83.9	52,000.00	4,362,800.00	4,362,800.00	
34	Muhareem	Rahim	Noka	2884	305/18-B	Apartament							-				41.5	41.5	52,000.00	2,158,000.00	2,158,000.00	Ndërtesa ngrihet mbi truallin me nr. pasurie 305/8. Mbi pasurinë është vendosur hipotekë ligjore.
35	Vll	Bajram	Metallari	2884	305/1	Truall + ndërtesë	500.3	482.4	3,560.00	1,717,344.00			-				305.4	305.4	52,000.00	15,080,800.00	17,598,144.00	
36	Kapllan	Asllan	Tola	2884	240/2	Truall + ndërtesë	496.60	496.6	3,560.00	1,767,896.00			-				169	169.00	52,000.00	8,788,000.00	10,555,896.00	Objekti ndihëhet do të paraqitet në kartelën e pasurisë gjatë publikimit të kërkesës për shpronësim.
37	Xhemali	Hysni	Allaraj	2884	240/16/ND	Ndërtesë							-				112.3	112.30	52,000.00	5,839,600.00	5,839,600.00	Pasuria pozicionohet mbi pasurinë nr. 240/16, vol.18, f. 88, në pronësi shtet vendoset hipotekë ligjore deri në pagesën e parcelës ndërtimor.
38	Teki	Xhevdet	Mandri	2884	240/11	Truall + ndërtesë	374.90	282.5	3,560.00	1,005,700.00			-				169.1	169.10	52,000.00	8,793,200.00	9,798,900.00	
39	FIRMA	VEFA	HOLDING	2884	265/2	Truall	2,065.00	1645		5,856,200.00				116.50	116.5	1522977					7,379,177.00	
40	Skender	Eqerem	Ahmadi	2884	223/1	truall + ndërtesë	300.00	196.1	3,560.00	698,116.00			-				117.2	117.20	52,000.00	6,094,400.00	6,792,516.00	
41	Eduart	Mark	Gimaj	2884	240/21	truall + ndërtesë	151.80	151.8	3,560.00	540,408.00			-				50.6	50.60	52,000.00	2,651,200.00	3,171,608.00	
42	Mustafa	Sulejman	Kabiti	2884	31/3/ND2	Ndërtesë							-				80	80.00	52,000.00	4,160,000.00	4,160,000.00	Objekti pozicionohet mbi pasurinë nr. 31/3, vol. 11, f. 41, në pronësi shtet sipërfaqja e parcelës për zhvillim 509m² në pronësi shtet.
43	Zef	Ndoc	Bushgjoka	8310	10/79-ND	Ndërtesë											46.46	46.46	96,753.41	4,495,163.43	4,495,163.43	
44	Fejzo	Hekuarin	Rapanj	8310	10/49-ND	Ndërtesë											45	45.00	96,753.41	4,353,903.45	4,353,903.45	Ndërtesa me nr. pas 10/49-ND, ndodhet mbi pasurinë nr. 10/49.
45	Zalo	Bajram	Topci	2460	606-ND11	Ndërtesë											147.7	147.7	66,505.00	9,822,788.50	9,822,788.50	Kjo ndërtesë ndodhet mbi pasurinë nr. 606, l. leg.
SHUMA TOTALE										49,451,126.80				712,768.00		1522977				267,485,823.20	319,172,695.00	

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë